



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr. 3357/ Prot.
1

Tiranë, më 13.10.2023

NJOFTIM PËR VENDE PUNE

A. Lëvizja paralele

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Kreu V – "*Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*", nenit 25, "*Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive*" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.3.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", i ndryshuar, Kreu VII dhe planit vjetor të pranimin në shërbimin civil, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se;

a) Në Administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune, të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm në pozicionin:

- Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se, ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil.

Paga e pozicionit- IV-1

Në përputhje me Vendimin nr. 90, datë 22.12.2022, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.55/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave"*, të ndryshuar.

b) Përshkrimi i detajuar i vendit të punës

Specialisti në Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, si detyrë të tij kryesore ka ndërgjegjësimin dhe trajnimin e zyrtarëve për zbatimin korrekt të ligjit, komunikimin periodik me autoritetet përgjegjëse në institucionet publike, si dhe përditësimin e listës së zyrtarëve që janë subjekte deklaruese. Ka përgjegjësi në korrespondencën dhe marrëdhëniet me autoritetet përgjegjëse, dhënien e asistencës për plotësimin e deklaratës së interesave privatë dhe konsulencës për zyrtarët publikë dhe autoritetet përgjegjëse. Kryerjen e kontrollit paraprak për deklarimin e interesave privatë, si dhe propozon marrjen e masave administrative në rastet e shkeljeve të afateve nga zyrtarët.

c) Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi, *(Të vërtetuar me një dokument nga institucioni)*;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

ç) Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor, përfshirë dhe diplomën Bachelor apo të barasvlefshme me diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND), në degën “Drejtësi”, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Të ketë përvojë mbi 1 vit në drejtim të fushës përkatëse të studimit;
- Të ketë njohuri në një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze;
- Të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike;
- Aftësi të mira komunikuese, organizative dhe punës në grup.

d) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Jetëshkrimi i plotësuar;
- Fotokopje e diplomës në degët e kërkuara *(Përfshirë dhe diplomën Bachelor)*. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet t’a ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- Vlerësimet e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- Fotokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

dh) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 24.10.2023

e) Në datën 26.10.2023, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve, që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, të kërkuara më sipër në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al. Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet postës elektronike (e-mail).

Kandidatët që rezultojnë të pakualifikuar, paraqesin ankesat me shkrim në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Konkurrimi - intervista me gojë do të bëhet më datën 8.11.2023, në mjediset e ILDKPKI, në orën 10:00.

ë) Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurrimi

Konkurrimi për kandidatiët, do të bazohet në njohuritë për:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Kodi i Procedurave Penale;
- Kodi i Procedurave Civile;
- Ligji për arkivat;
- Ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, *“Rregullat e etikës në administratën publike”*;
- Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, si dhe pyetje të tjera nga specialiteti.

f) Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm, i ngritur pranë ILDKPKI.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë për dokumentacionin dhe
- 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Dokumentacioni i dorëzuar i ndarë:

- 20 pikë për përvojën,
- 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet në fushën përkatëse dhe
- 10 pikë për çertifikimin pozitiv.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën, në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës,
- Eksperiencën e tyre të mëparshme,
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

g) Lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve) do të shpallet në datë 9.11.2023 në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë.



Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Nëse nuk ka fitues, nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreut IV – “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr.152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Kreu II Pranimi në shërbimin civil

B. Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, procedura do të vazhdojë me plotësimin e vendeve të lira pune, të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm në pozicionin, **Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse**.

Ky informacion do të vendoset në dispozicion në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Edhe për këtë procedurë aplikohet në të njëjtën kohë.

a) Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurrimi

Konkurrimi për kandidatiët, do të bazohet në njohuritë për:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Kodi i Procedurave Penale;
- Kodin e Procedurave Civile;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji për arkivën;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe pyetje të tjera nga specialiteti.

b) Konkurrimi

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza;

- 1) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta.
- 2) Vlerësimi i kandidatëve.

c) Pëshkrimi i detajuar i vendit të punës

Specialisti në Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, si detyrë të tij kryesore ka ndërgjegjësimin dhe trajnimin e zyrtarëve për zbatimin korrekt të ligjit, komunikimin periodik me autoritetet përgjegjëse në institucionet publike, si dhe përditësimin e listës së zyrtarëve, që janë subjekte deklaruese. Ka përgjegjësi në korrespondencën dhe marrëdhëniet me autoritetet përgjegjëse, dhënien e asistencës për plotësimin e deklartës së interesave privatë dhe konsulencës për zyrtarët publikë dhe autoritetet përgjegjëse. Kryerjen e kontrollit paraprak për deklarimin e interesave privatë, si dhe propozon marrjen e masave administrative, në rastet e shkeljeve të afateve nga zyrtarët.

ç) Kërkesat e përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar;

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

d) Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon;

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor përfshirë dhe diplomën Bachelor apo të barasvlefshme me diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND), në degën “Drejtësi” sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Të ketë përvojë mbi 1 vit, në drejtim të fushës përkatëse të studimit;
- Të ketë njohuri në një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze;
- Të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, organizative dhe të punës në grup.

dh) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Jetëshkrimi i plotësuar;

- Fotokopje e diplomës në degën e kërkuar, (*Përfshirë dhe diplomën Bachelor*). Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje të listës së notave;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e tij;
- Fotokopje të kartës së identitetit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

e) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 31.10.2023

ë) Më datë 6.11.2023 do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpk.al. Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër. Ankesat nga kandidatët paraqiten brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet adresës së postës elektronike (email).

f) Konkurrimi - testimi me shkrim dhe intervista me gojë, do të bëhet më datë 21.11.2023, në orën 10:00, në ambjentet e ILDKPKI.

g) Mënyra e vlerësimit

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- vlerësimi i jetëshkrimit - 15 pikë,
- intervista e strukturuar me gojë - 25 pikë,
- testimi me shkrim - 60 pikë.

Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, kur kandidati merr më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë), kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit. Nëse kandidati merr mbi 45 (dyzet e pesë) pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

gj) Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën, në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Lista e fituesve do të jetë me kandidatët që kanë fituar mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve).

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ILDKPKI do t'i njoftojë ata individualisht, nëpërmjet postës elektronike (e-mail).

Njoftimi i fituesit do të bëhet në **datën 22.11.2023**, në portalin "*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*", si dhe në faqen zyrtare të ILDKPKI www.ildkpkj.al.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të ILDKPKI.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga "*Reshit Çollaku*", Tiranë.

ILDKPKI
NJËSIA PËRGJEGJËSE